

20040170289

L I G J I
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA NË BANKËN
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKËN BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN PËR MODERNIZIMIN E
ARSIMIT

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankën Botërore me hua në shumë prej 5 milionë (5.000.000,00) dollarë amerikan, dedikuar për realizimin e Projektit për modernizimin e arsimit.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua sipas Projektit për modernizimin e arsimit, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huasë nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, duke përfshirë grejs periudhën prej 5 vitesh dhe shkallën e kamatës prej LIBOR + 0.75% në vit.

Huaja do të paguhet në 24 anuitete gjysmëvjetore prej të cilave duke filluar nga 15 maji i vitit 2009 deri më 15 maj të vitit 2020 do të paguhet 23 anuitete të barabarta në shumë prej 210.000 dollarë amerikan dhe më 15 nëntor të vitit 2020 do të paguhet anuiteti i fundit në shumë prej 170.000 dollarë amerikan.

Në grejs periudhën prej 5 vitesh, që paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huasë.

Neni 4

Në datën ose menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 2, paragrafi 1 i këtij ligji, paguhet provizioni i njëfishtë-shpenzimi prej 1% nga shuma e huasë.

Në shumën e mjeteve të patërhequra të huasë paguhet provizioni në lartësi prej 0,75% në vit i përcaktuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore.

Provizioni nga paragrafi 2 i këtij neni paguhet në gjashtë muaj, më 15 maj dhe 15 nëntor për çdo vit.

Neni 5

Shfrytëzues i mjeteve të huasë për Projektin për modernizimin e arsimit është Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huanë nga neni 1 i këtij Ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.